



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Primitje: Mbi/Dana 08-05-2024 vit/god			
Nr./ organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetë Prilog	Vlera Vlerësoet
12-	035/02-		699



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Komisioni për ankesa në përbërje, Avdirrahman Sadiku (kryesues i komisionit), Arian Alidema (anëtar), Fatlum Demiri (anëtar), në mbledhjen e mbajtur me datën 03.05.2024, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ankesës, si: ankesën e OJQ-së “Shoqata për Promovimin e Cilësisë në Arsim SHPCA” me Nr.12-320/04-13138, e datës 25.04.2024 kundër Vendimit të listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-035/02-639, i datës 22.04.2024, në përputhje me neni 9 dhe 21 të Rregullores MF – Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, komisioni merr këtë:

## V E N D I M

1. **Aprovohet pjesërisht si e bazuar** ankesa e OJQ-së “Shoqata për Promovimin e Cilësisë në Arsim SHPCA” me Nr.12-320/04-13138, e datës 25.04.2024 kundër Vendimit të listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-035/02-639, i datës 22.04.2024
2. **Obligohet** komisioni për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-035/02-639, i datës 22.04.2024, që në afat prej 5 dite të rivlerëson aplikacionin e OJQ-së në fjalë.
3. **Mbetet në fuqi** Vendimit i listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-035/02-639, i datës 22.04.2024

## Arsyetim

Komisioni për ankesa, në mbledhjen e mbajtur me datën 07.05.2024 shqyrtoj ankesën e OJQ-së “Shoqata për Promovimin e Cilësisë në Arsim SHPCA” me Nr.12-320/04-13138, e datës 25.04.2024, kundër Vendimit të listës preliminare të komisionit për ndarjen e subvencioneve të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport Nr. 12-035/02-639, i datës 22.04.2024, të publikuar nga komisioni prej 5 anëtarëve, me pretendime se nuk jemi vlerësuar nga komisioni vlerësues me arsyetimin e mungesës së dokumentacionit, mungesës së dëshmisë për implementimin të projekteve, jashtë fushës së thirrjes.

Komisioni i ankesave, bazuar në vlerësimet e hollësishme të çdo prove veç e veç dhe çdo prove së bashku, si dhe bazuar në rezultatet e tërësishme të shqyrtimit administrativ, konstatoj se, ankesa e ankuesit OJQ “Shoqata për Promovimin e Cilësisë në Arsim SHPCA” është **pjesërisht e bazuar**, sepse:

Nga administrimi i dosjes së lëndës rrjedh se Komuna e Vitisë ka shpallur Thirrjen Publike Nr.02-035/02-176 me datë 01.02.2024, me ç’rast ka ftuar OJQ-të të cilat veprojnë në Komunën e Vitisë që të aplikojnë bazuar në kriteret e përcaktuara në thirrje publike, e cila ka qenë e hapur për aplikim që nga data 01.03.2024 deri me datë 29.03.2024 . Me ç’rast kanë aplikuar gjithësej 31 OJQ. Komisioni vlerësues me rastin e vlerësimit të aplikacioneve ka vlerësuar se, duhet të përkrahen projektet e 26 OJQ-ve, ndërsa për 5 OJQ projekte e tyre i ka refuzuar me arsyetim se janë në kundërshtim me thirrjen publike.

- Komisioni i ankesave, përmes kryetari të komisionit për ankesa, Avdirrahman Sadiku, me datën 03.05.2024 ka kërkuar nga anëtarët e komisionit vlerësues dokumentacionet, konkretisht aplikacionin e OJQ-së “Shoqata për Promovimin e Cilësisë në Arsim SHPCA”.

- Komisioni për shqyrtimin e ankesave gjatë shqyrtimit të ankesave, konkretisht ankesës së OJQ-së “Shoqata për Promovimin e Cilësisë në Arsim SHPCA” me Nr.12-320/04-13138, e datës 25.04.2024 konstaton që, aplikacioni i OJQ-së “Shoqata për Promovimin e Cilësisë në Arsim SHPCA” të vlerësohet edhe njëherë nga komisioni vlerësues, sepse projekti ka të bëjë me aktivizimin e rinisë dhe përputhet me thirrjen publike për mbështetje financiare të entiteteve publike. Komisioni për shqyrtimin e ankesave konstaton që, aplikacioni i OJQ-së “Shoqata për Promovimin e Cilësisë në Arsim SHPCA” duhet të vlerësohet edhe njëherë nga komisioni vlerësues, bazuar edhe nga vlerësimet e OJQ-ve të tjera të cilat janë vlerësuar pozitivisht nga komisioni për ndarjen e subvencioneve sipas Vendimit preliminar të datës 22.04.2024.
- Komisioni i ankesave me rastin e shqyrtimit të ankesës në fjalë, në përputhje me dispozitat e nenit 21 të Rregullores MF – Nr.04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në përputhje me nenin 131 dhe 132 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031, ka shqyrtuar edhe disa aplikacione të OJQ-ve të cilat për nga përmbajtja dhe qëllimi i projektit, emërtimi i projektit apo programi kanë thuaja së promovimin, sensibilizimin e aktiviteteve të rinisë në Komunën e Vitisë e të cilat në programet e tyre kanë parapa pjesmarrjen e rinisë dhe nxënësve të shkollave në projektet e tyre e të cilat janë vlerësuar për të përkrahur siç janë: OJQ “Shoqata e Pedagogve Sportiv”, “Promovimi i shendetit tek nxënësit e Vitisë” në shumë e mjeteve prej 2700 euro për përkrahje financiare; OJQ “Politeia”, "Vullnetarizimi tek të rinjtë", në shumën e mjeteve 1500 euro; OJQ “Klubi i Pingpangut Vitia”, "Masovizimi i pingpangut dhe rinia", në shumën e mjeteve prej 1500 euro; OJQ “Sh.F Kosova” “Avancimi i rinisë në sport”, në shumën e mjeteve prej 1900 euro.
- Pra, për komisionin e ankesave është me rëndësi që aplikacioni i OJQ-së ankuese të shqyrtohet dhe vlerësohet përsëri nga komisioni vlerësues, bazuar në arsyetim të këtij vendimi dhe aplikacionit të OJQ-së “Shoqata për Promovimin e Cilësisë në Arsim SHPCA”, sepse me rastin e refuzimit të aplikacionit të ankuesit, komisioni vlerësues nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, andaj, mbi bazën e të gjeturave dhe konstatimeve si më lartë, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, në përputhje me Ligjin mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 dhe Rregullores MF-04/2017, duke pasur parasysh interesin publik dhe ofrimin e mbështetjes për OJQ-të të cilat kontribuojnë në jetën e përditshme rinore, kulturore, sportive etj, dhe me qëllim të respektimit të ligjshmërisë, dyshkallëshmërisë së vendosjes, financimin përmes fondeve publike të projekteve dhe programeve që janë me prioritet, dhe të atyre që për her të parë aplikojnë bazuar në praktikën e viteve të mëhershme, ku meqerast çdo OJQ gjatë një viti të caktuar kanë qenë aplikues për herë të parë dhe nuk kanë pasur përvojë apo projekte të mëparshme, por të njejtat janë përkrahur me mjete financiare nga komisionet vlerësuese të viteve paraprake, andaj komisioni vlerëson se aplikacioni i ankuesit duhet të rivlerësohet.  
Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshilla Juridike:** Vendimi i komisionit të ankesave është vendim përfundimtar në procedurën administrative, andaj palët e pakënaqura kanë të drejtë ankese në afat prej 30 dite nga data e pranimit të vendimit pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative.

Vendimi ju dërzohet:

1. OJQ-së ankuese;
2. Komisionit vlerësues;
3. Komisionit të ankesave;
4. Arhivës komunale:

Viti, më 08.05.2024

Avdirrahman Sadiku, kryesues i komisionit

Arian Alidema, anëtar

Fatlum Demiri, anëtar

